



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 127, datë 30.07.2018

PËR

LICENCIMIN E Z. ALTIN KËNUTI SI VLERËSUES I DËMEVE SHËNDETËSORE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 227, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, me propozim të Zyrës së Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Altin Kënuti për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve shëndetësore në sigurime në klasën e Jo-Jetës:
 - Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit.
2. Licenca shoqërohet me deklaratën personale të nënshkruar nga vlerësuesi, sipas formatit bashkëlidhur.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

DEKLARATË PERSONALE

Unë i nënshkruari, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se në zbatim të nenit 227, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, dhe Ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm së sektorin e transportit” të ndryshuar, do të ushtroj veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në mënyrë të pavarur, në përputhje me standardet profesionale dhe do të zbatoj kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurimeve dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Jam i ndërgjegjshëm dhe pranoj se mos plotësimi i kërkesave të mësipërme mund të jetë subjekt i masave të marra nga Bordi i AMF deri në tërheqjen e licencës.

Me respekt,
